



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Më datë 22.09.2017, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor me Kompetencë të Përgjithshme Vinicë, e cila është vizita e parë në këtë Stacion policor nga ana e Ekipit të Mekanizmit Parandalues Nacional.

Vizita buron nga mandati i Avokatit të Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional, e parashikuar me Protokollin Fakultativ, ndaj Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese dhe Ndëshkuese dhe Ligji i Avokatit të Popullit. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet zbatimi i vizitave të rregullta në vendet ku mund të kryhet privimi nga liria i personave, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Ekipi i MPN-së kishte bashkëpunim dhe kooperim të mirë nga ana e nëpunësve zyrtarë të punësuar në Stacionin policor, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te hapësirat dhe instalimet, si dhe këqyrje në dokumentacionin e kërkuar.

Stacioni policor Vinicë është vendosur në objekt me ndërtim të fortë, në kuadër të këtij objekti gjenden edhe zyrat e personave zyrtarë. Në hyrje të Stacionit të policor ka rampë të aksesshme për personat me aftësi të caktuar fizike, me çka mundësohet qasja papengesë deri në hapësirat zyrtare të SP Vinicë.

Gjatë këqyrjes në hapësirat zyrtare, në njërën nga zyrat e inspektorëve, ku njëkohësisht bëhet edhe marrja në pyetje e personave të dyshuar për vepra të kryera penale, Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional gjeti sende për të për të cilat ekziston dyshim i bazuar se rezultojnë nga vepra e kryer penale ose nga kundërvajtja, dhe të cilat eventualisht do të mund të përdroreshin për frikësimin e personave të arrestuar, përkatësisht personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar. Në këtë drejtim, MPN-ja rekomandon që sendet e këtilla çdoherë duhet të vendosen dhe magazinohen në hapësirat për sende të sekuestruara dhe armë.

Në momentin e vizitës nuk kishte persona të ndaluar në SP Vinicë, me të cilët Ekipi i MPN-së do të mund të bisedonte lidhur me trajtimin e tyre nga ana e nëpunësve policorë, për realizimin e të drejtave të tyre, si dhe për kushtet e ndalimit në këtë stacion policor.

Konform Aktvendimit për përcaktimin e stacioneve policore për ndalimin e personave, ky stacion policor është caktuar si stacion policor i cili mund të zbatoj ndalim, megjithatë, i njëjti nuk i përmbush standardet e parashikuara minimale vendore dhe ndërkombëtare. Në afërsi të hapësirave gjendet nyja sanitare, e cila dedikohet vetëm për

personat e ndaluar dhe e njëjta është funksionale, në rregull dhe në gjendje krejtësisht korrekte.

Nga këqyrja në hapësirat e ndalimit, Ekipi i MPN-së konstatoi se të njëjtat janë me sipërfaqe prej 4,3 m² dhe 6,5 m² dhe i përmbushin standardet minimale ndërkombëtare për ndalimin e personave. Hapësirat janë të pastra, të rregullta dhe në to nuk ka lagështirë (janë matur 34% R.H.). Temperatura në hapësira ishte 21°C, megjithatë, në to nuk kishte kurrfarë trupa për ngrohje e që do të mund të paraqiste problem gjatë periudhës dimërore kur temperaturat janë jashtëzakonisht të ulëta.

Në hapësirat e ndalimit nuk është instaluar sistemi për thirrje (alarm), të cilin personat e ndaluar do ta përdornin për të alarmuar në raste të situatave kur do të kenë nevojë për intervenim ose komunikim me përgjegjës të turnit, ndërkaq nuk ka as video mbikëqyrje funksionale, si në korridorin para hapësirave, ashtu edhe në vet hapësirat për ndalim, përmes së cilit përgjegjësi i turnit dhe nëpunësit e tjerë policorë do ta zbatonin mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi personat e ndaluar.

Ekipi i MPN-së, u njoftua se Stacioni policor disponon me buxhet për ushqim (1000,00 den.) për personat e arrestuar, personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, në përputhje me Procedurat Standarde Operative për trajtimin e personave të ndaluar, në të cilat është parashikuar se çdo personim i cili ndalohet më shumë se 6 orë, i takon një porcion ushqimi.

Mbikëqyrja e personave të ndaluar kryhet drejtpërsëdrejti nga ana e përgjegjës të turnit dhe nëpunësve policorë të shërbimit kujdestar, përmes këqyrjes së drejtpërdrejtë në hapësirat e ndalimit. MPN-ja realizoi këqyrje në disa fletë-kontrolli dhe konstatoi se kontrolli i drejtpërdrejt, që është vendosur si praktikë në këtë Stacion policor, më së shpeshti zbatohet në intervalin kohor prej çdo 35 minuta deri në 1 orë, e që në mungesë të video-mbikëqyrjes në hapësirat e ndalimit kontribuon për parandalimin e vetëlëndimit ose reagimin në kohë të nëpunësve policorë.

Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi këqyrje në dokumentacionin e plotë, i cili udhëhiqet për personat e arrestuar ose personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, me ç'rast u konstatua se i njëjti në mënyrë kronologjike mbahet në rregull, me rrjedhë logjike të ngjarjeve, ndërlidhje të ndërsjellë dhe me të dhëna përkatëse. Nga këqyrja e regjistrave dhe dosjeve u konstatua se, personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar, udhëzohen në kohë për të drejtat e tyre dhe se respektohen të drejtat për njoftimin e personit të tretë për ndalimin e tyre, të thirrin mbrojtës apo të kërkojnë ndihmë mjekësore. Personave, të cilët janë ndaluar më shumë se 6 orë, u sigurohet një porcion ushqimi nga mjetet të cilat për këtë dedikim i posedon Stacioni policor, për çka në mënyrë përkatëse përpilohet shënim zyrtar. Ekipi i Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se në dosjet e personave të ndaluar përfshihen edhe fletë-kontrollet për vizitat e realizuara nga ana e nëpunësve policorë, në intervale të rregullta kohore, të cilat zbatohen me qëllim të parandalimit të vetëlëndimit dhe përcaktimit të gjendjes së personit të ndaluar.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Stacionit policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë dhe rreziqet.